



Pranuar / Dorezuar Prilazhen/Prilazho Received/Delivered	08 - 11 - 2022	vin god year	
Organ /Rjesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtori e Pilog Appendis	Sasia Kolicina Quantity
SKIPNSHDK	6910/2022		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.884/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.884/2022 të datës 10.10.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi

kundër organit të punësimit/Zyra e Kombëtare e Auditimit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 08.11.2022, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës *Shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.884/2022 të datës 10.10.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi kandidat në procedurën e rekrutimit sipas Konkursit me numër reference: RNAP/ZKA/17-08/2022 të datës 16.07.2022, për pozitën e punës *Ndihmës Auditor i Përgjithshëm* në Zyrën Kombëtare të Auditimit, me datë 10.10.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6005/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.884/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër mënyrës se aplikimit të procesit të përzgjedhjes së Ndihmës Auditorit të Përgjithshëm, Njoftimit me numër protokolli 1726 të datës 08.09.2022 dhe kundër Vendimit me numër protokolli 1861 të datës 27.09.2022 të Komisionit të Ankesave pranë Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 13.10.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Zyra Kombëtare e Auditimit, ndërsa kjo e fundit me datë 27.10.2022 ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 6005/2022 të datës 10.10.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Ligjin për Zyrat Publik (faqe 1 dhe 41); Aktgjykimin Nr. Ref. AGJ 1583/20 në rastin nr.KO203/19 parashtrues Avokati i Popullit: Ligjin e Punës (faqe 1); Udhëzimin administrativ me numër 371 të datës 19.10.2017; Vendimin me numër 01Nr.06-81-1/2017; Konkursin me numër reference NAP/ZKA/13-07/2022 për pozitën Ndihmës Auditor i Përgjithshëm; Njoftimin me numër 07/1-112-1507 të datës 03.08.2022 lidhur me anulimin e konkursit në fjalë; Njoftimin me numër 07/2-112-1660 të datës 23.08.2022 të kandidateve të përzgjedhur për intervistë; Njoftimin me numër 07/2-112-1687 të datës 30.08.2022; Vendimin me numër 10/4-112-1626 të datës 22.08.2022 për themelimin e komisionit për zhvillimin e procedurave të përzgjedhjes; Formularin zyrtar të konkurrimit të datës 01.08.2022 të ankuesit; Pyetjet për interviste me gojë të datës 06.09.2022; Raportin përmbledhës për rezultatet e procesit për përzgjedhjen në pozitën e punës Ndihmës i Auditor i Përgjithshëm në numër reference RNAP/ZKA/17-08/22; Rregulloren (ZKA)Nr.03/2021 për pranim dhe karrierë në zyrën kombëtare të Auditimit; Ankesën me numër të protokollit 10/3-112-1773-47 të datës 15.09.2022 drejtuar Komisionit të Ankesave në Zyrën e Auditimit; Vendimin me numër 10/3-112-1861/5 të datës 27.08.2022; Emalin e datës 20.09.2022 të drejtuar Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 6150/2022 të datës 13.10.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 6489/2022 të datës 27.10.2022; Kontratën e punës me numër 10-43-829-7 të datës 28.06.2017; Vendimin me numër të protokollit 6003/2018 të datës 15.10.2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë administrimit të provave të lëndës ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës *nuk është kompetent* për të vendosur për ankesën A.nr.884/2022 të datës 10.10.2022 të parashtruar nga ankuesi

SEPSE:

Nga analizimi i shkresave të lëndës rezulton se Zyra Kombëtare e Auditimit duke u bazuar në dispozitat e nenit 9 paragrafi 2 dhe nenin 15 të Ligjit Nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, me datë 16.07.2022 ka shpallur Konkursin me numër reference: RNAP/ZKA/17-08/2022 për pozitën e punës *Ndihmës Auditor i Përgjithshëm*, në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesi

I pakënaqur me rezultatin e procesit të intervistimit, ankuesi me datë 15.09.2022 kishte parashtruar ankesë me numër protokollit 1773 në Komisionin e Ankesave pran Zyrës Kombëtare të Auditimit. Kjo e fundit me datë 27.09.2022 me Vendimin Nr.15/2022 kishte refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar dhe kishte lenë në fuqi Njoftimin e datës 08.09.2022 për rezultatet e procesit të intervistimit për vendin e punës *Ndihmës Auditor i Përgjithshëm*.

Ankuesi, kundër Vendimin Nr.15/2022 të datë 27.09.2022 të Komisionit të Ankesave, me datë 10.10.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.

Kolegji i Këshillit, në mbështetje të dispozitave të nenit 131 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, lidhur me pranueshmerinë e ankesës analizoi dispozitat e Ligjit Nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 15 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: 1. *Legjislacioni përkatës për shërbimin civil, nuk zbatohet vetëm për Auditorin e Përgjithshëm, zëvendës auditorin e*



përgjithshëm, ndihmës auditorët e Përgjithshëm dhe auditorët e Zyrës Kombëtare të Auditimit, ndërsa stafi tjetër trajtohet në bazë të Ligjit për Shërbimin Civil. 2. Bazuar në legjislacionin në fuqi, Auditori i Përgjithshëm nxjerr rregullore dhe udhëzues për mënyrën e trajtimit të të gjitha çështjeve në lidhje me burimet njerëzore. Duke e bërë këtë, do të merren parasysh vlerat dhe parimet në Ligjin për Shërbimin Civil dhe Ligjin e Punës, dhe rrjedhimisht duke ju referuar Aktgjykimin në rastin KO203/19 të datës 9 korrik 2020 të Gjykatës Kushtetuese, me të cilin është konstatuar se neni 2 paragrafi 3 (fusha e zbatimit) dhe neni 85 i Ligjit Nr.06/114 për Zyrtaret Publikë nuk janë në pajtueshmëri me nenin 136 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës] të Kushtetutës, Kolegji i Këshillit konstaton se pozita e punës Ndihmës Auditorë i Përgjithshëm në të cilën ka aplikuar ankuesi nuk hynë në kuadër të pozitave të punës me status të nëpunësit civil dhe si rrjedhojë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për shqyrtimin e ankesës A.nr.884/2022 të datës 10.10.2022 të parashtruar nga ankuesi

Rrjedhimisht, sipas dispozitave të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent të shqyrtoj dhe të vendos vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në shërbimin civil.

Bazuar në legjislacionin pozitiv të Zyrës Kombëtare të Auditimit, si dhe duke marr parasysh se ankuesi ka shfrytëzuar mjetet ankimore brenda institucionit përkatës të punësimit, Kolegji i Këshillit e udhëzon palën ankuese për iniciimin e kontestit të punës në gjykatën kompetente.

Për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBYMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.884/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Jeton Koca

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- Udhëheqësit të Personelit në Zyrën Kombëtare të Auditimit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

